



20 mars 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Kujdesi Parësor Shëndetësor i Prizrenit me shumë mangësi në organizimin e kujdestarive

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë pjesës së parë të muajit mars ka hulumtuar çështjen e pagesës së kujdestarive në Kujdesin Parësor Shëndetësor të Komunës së Prizrenit.

Hulumtimi disa javor i "EC Ma Ndryshe" ka nxjerrë në pah faktin se ndonëse gjatë vitit 2012 janë grumbulluar mjete të konsiderueshme nga bashkë pagesat e pacientëve, ato nuk kanë mjaftuar për të mbuluar kujdestaritë respektivisht për të kryer obligimet ndaj personelit mjekësor, që janë të angazhuar në Kujdesin Parësor Shëndetësor, edhe pse një gjë e tillë garantohet me Kontratën Kolektive Sektoriale. Një gjë e tillë ka bërë që disa Qendra të Mjekësisë Familjare prej disa muajsh të jenë të mbyllura gjatë ditëve të vikendit.

Të dhënat e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi tregojnë se në vitin 2012 nga bashkë pagesat janë grumbulluar rreth 196 mijë euro derisa afër 30 mijë euro janë bartur nga viti 2011, që në total bëjnë 225 mijë euro. Nga këto mjete mbi 90 mijë euro janë ndarë për pagesën e kujdestarive derisa rreth 88 mijë euro janë shpenzuar për pagat e punonjësve shëndetësor të nivelit primar.

"Me këto mjete të bashkë pagesave e kemi plotësuar "minusin" në pozicionin e pagave të punëtorëve. Ky "minus" në paga për vitin 2012 ka qenë si pasojë e gabimit në planifikim të pagave për vitin 2012, nga Ministria e Financave", thuhet në përgjigjen e DKSH-së, drejtuar "EC Ma Ndryshes", ku potencohet se borxhi i mbetur për kujdestari për vitin 2012 është 35 mijë euro.

Gjatë kësaj periudhe "EC Ma Ndryshe" ka intervistuar edhe punonjës shëndetësor të nivelit parësor, të cilët kanë shprehur pakënaqësi në lidhje me mos pagesën e kujdestarive nga shtatori i vitit të kaluar e deri në janar të këtij viti, ndërkohë që ka vonesa edhe nga 6 muaj në pagesat e kujdestarive të mëhershme. Sipas tyre kujdestaritë që nga pas luftime janë paguar me rregull, deri në shtator të 2012-ës, kur është ndërprerë kjo praktikë, që për pasojë ka sjellë edhe mbylljen e QMF-1, QMF-2 dhe QMF-3 në fundjava. Ata kanë shpjeguar se rikthimi i pagesave nga shkurti, ka bërë që vetëm QMF-1 të kthehet në funksion gjatë vikendeve, derisa QMF-2 dhe QMF-3 ende nuk punojnë.

Këto pretendime janë konfirmuar nga krerët e Kujdesit Primar Shëndetësor, drejtori i DKSH-së, Nexhip Berisha dhe drejtori i QKMF-së, Mehmedali Gashi. Në një reagim publik ata kanë pranuar se: "Që nga shtatori i vitit të kaluar kujdestaritë gjatë vikendeve u reduktuan në disa QMF për shkak të pamundësisë së pagesës së tyre. Kujdestaritë paguhen ekskluzivisht nga të hyrat e bashkë pagesave. Arsyeja tjetër ka qenë se me këtë reduktim në kursyem shpenzimet tjera si: nxehjen qendrore, energjinë elektrike etj. Këtë organizim të atëhershëm të kujdestarive e bëmë në qendrat ku kishte numër më të vogël të pacientëve gjatë vikendit. Gjatë gjithë kësaj periudhe

pacientët nuk janë dëmtuar aspak, sepse shërbimet shëndetësore i kanë marrë në QKMF, e cila ka funksionuar 24 orë”.

EC Ma Ndryshe konsideron se këto arsytetime nuk janë të qëndrueshme për faktin se Kujdesi Parësor Shëndetësor ka gjeneruar mjaft të hyra nga bashkë pagesat që të siguroj kujdestaritë respektivisht shërbimin 24 orësh në të gjitha QMF-të. Mirëpo mos koordinimi i duhur ndër-institucional ka bërë që të ketë gabime në planifikimin e pagave për vitin 2012. Gjithashtu, thirrja në kursim të ngrohjes qendrore, energjisë elektrike, etj është i pakuptimtë, meqë funksionimi i atyre QMF-ve është i bazuar në normat ligjore të Shëndetësisë Primare.

EC Ma Ndryshe duke adresuar shqetësimet e banorëve të këtyre lagjeve i bën thirrje ekzekutivit komunal që në afatin sa më të shkurtër t’i qartësoj mosmarrëveshjet apo gabimet me MF-në, në mënyrë që të ketë planifikim të duhur të pagave por edhe të kujdestarive, me qëllim që qytetarët e Prizrenit të kenë shërbime të duhura mjekësore gjatë 24 orëve.

EC Ma Ndryshe apelon te drejtuesit e QKMF-së dhe të DKSH-së por edhe te niveli qendror që të jenë më të kujdesshëm në zbatimin e përgjegjësive të tyre institucionale, që të mos përsëriten situatat kur për shkak të gabimeve të tyre e pësojnë qytetarët dhe sakrifikohet shërbimi mjekësor 24 orësh.

EC Ma Ndryshe rekomandon edhe anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit që të jenë më aktiv në adresimin e problemeve të përditshme të qytetarëve por edhe në mbikëqyrjen e punës dhe financave të ekzekutivit komunal.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti “Transparenca online e komunës së Prizrenit” prej muajit shtator 2012
përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*